

KONTRATE DHURIMI KUOTASH

Ne Tirane, sot me date 8 Maj 2018, lidhet kjo kontrate dhurimi kuotash ("**Kontrata**"), me pale si me poshtë vijon:

- **Z. Sokol Xhabafti** shtetas shqiptar, lindur me 03.01.1969, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 024623808 dhe nr. personal G901031261, madhor dhe me zotësi të plote për të vepruar, mbajtës i një kuote që përfaqëson 50% (pesëdhjete përqind) të kapitalit të shoqërisë WELL Shpk., një shoqëri e krijuar dhe që vepron në përputhje me legjislacionin shqiptar, me seli në adresën: Fshati Picar, Rruga e Serave, Objekt me nr. pasurie 245/26ND, ZK 3974, Vore, Tirane, Shqipëri, regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit me numër unik të identifikimit të subjektit (NUIS) L71416030S, (në vijim "**Dhuresi i pare**")

Dhe

- **Z. Neritan Bilibashi** shtetas shqiptar, lindur me 25.11.1969, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 029216534 dhe nr. personal G91125107D, madhor dhe me zotësi të plote për të vepruar, mbajtës i një kuote që përfaqëson 50% (pesëdhjete përqind) të kapitalit të shoqërisë WELL Shpk., një shoqëri e krijuar dhe që vepron në përputhje me legjislacionin shqiptar, me seli në adresën: Fshati Picar, Rruga e Serave, Objekt me nr. pasurie 245/26ND, ZK 3974, Vore, Tirane, Shqipëri, regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit me numër unik të identifikimit të subjektit (NUIS) L71416030S, (në vijim "**Dhuresi i dyte**")

Këtu e në vijim referuar bashkërisht si "**Dhuresit**"

Dhe

- **Z. Manfred Laaber**, shtetas Austriak, lindur me 10.09.1957, mbajtës i pasaportës nr. P 7416269, madhor dhe me zotësi të plote për të vepruar, (në vijim "**Përfituesi**")

Në vijim "**Dhuresit**" dhe "**Përfituesi**", bashkërisht do të quhen "**Palët**" dhe secili prej tyre "**Pala**".

MEQENESE

- A. Dhuresit, janë ortakë në shoqërinë **WELL Shpk.**, shoqëri e krijuar dhe që ekziston në përputhje me legjislacionin shqiptar, me seli në adresën: Fshati Picar, Rruga e Serave, Objekt me nr. pasurie 245/26ND, ZK 3974, Vore, Tirane, Shqipëri, e regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit me numër identifikimi të subjektit (NUIS) L71416030S, me kapital në vlerën 100 000 Leke (njëqind mijë) (në vijim "**Shoqëria**").
- B. Dhuresit deklarojnë se zotërojnë i 1 (një) kuote secili si vijon:



1. **Z. Sokol Xhabafti** zotërues i një kuote cila përfaqëson 50% (pesëdhjete përqind) te kapitalit te Shoqërisë e cila, me qellim dhurimi, është e ndare ne 3 (tre) kuota te cilat bashkërisht përfaqësojnë 50% (pesëdhjete përqind) te kapitalit te Shoqërisë, me vlere si me poshtë vijon:
 - i. 1 kuote, përbërëse e 32% (tridhjete e dy përqind) te kapitalit te Shoqërisë, me vlere 32 000 Leke (tridhjete e dy mije);
 - ii. 1 kuote, përbërëse e 14% (katërbëdhjetë përqind) te kapitalit te Shoqërisë, me vlere 14.000 Leke (katërbëdhjetë mije).
 - iii. 1 kuote, përbërëse e 4% (katër) te kapitalit te Shoqërisë, me vlere 4.000 Leke (katër mije) e cila i dhurohet z. Sabian Shabani me kontratën e dhurimit lidhur midis Z. Sokol Xhabafti dhe tij ne te njëjtën date me këtë kontrate.

2. **Z. Neritan Bilibashi** zotërues i një kuote cila përfaqëson 50% (pesëdhjete përqind) te kapitalit te Shoqërisë e cila, me qellim dhurimi, është e ndare ne 2 (dy) kuota te cilat bashkërisht përfaqësojnë 50% (pesëdhjete përqind) te kapitalit te Shoqërisë, me vlere si me poshtë vijon:
 - i. 1 kuote, përbërëse e 32% (tridhjete e dy përqind) te kapitalit te Shoqërisë, me vlere 32 000 Leke (tridhjete e dy mije);
 - ii. 1 kuote, përbërëse e 18% (tetëmbëdhjete përqind) te kapitalit te Shoqërisë, me vlere 18.000 Leke (mije).

- C. Dhuruesit **Z. Sokol Xhabafti dhe Z. Neritan Bilibashi** dëshirojnë t'i dhurojnë Përfituesit secili 1 (një) kuote te zotëruar prej tyre tek Shoqëria qe korrespondon respektivisht me 14% (katërbëdhjetë përqind) te kapitalit e zotëruar nga Z. Sokol Xhabafti dhe një kuote qe korrespondon respektivisht me 18% (tetëmbëdhjete përqind) te kapitalit e zotëruar nga Z. Neritan Bilibashi, pa kundër shpërblim (këtu e ne vijim referuar bashkërisht si "**Kuotat**");


- D. Përfituesi pranon Kuotat e mësipërme.

Sa me sipër, Dhuruesi dhe Përfituesi bien dakord te lidhin këtë Kontrate, me kushtet si vijon:

Neni 1

Objekti i Kontratës

- 1.1 Sipas kushteve dhe parashikimeve te kësaj Kontrate, Dhuruesit i transferojnë nëpërmjet dhurimit dhe kalojnë ne emër te Përfituesit, Kuotat e zotëruara prej tyre, te cilat përfaqësojnë 32% (tridhjete e dy përqind) te kapitalit te Shoqërisë, dhe Përfituesi përfiton këto Kuota nga Dhuruesit.
- 1.2 Përfituesi behet zotërues me te drejta te plota i 1 (një) kuote, përfaqësuese e 32% (tridhjete e dy përqind) te kapitalit te Shoqërisë (ne vijim "**Kuota**"), pas nënshkrimit te kësaj Kontrate.
- 1.3 Palët bien dakord qe pas nënshkrimit te kësaj Kontrate, Përfituesi do te jete prorar dhe do te ushtroje te gjitha te drejtat qe lidhen me Kuotën dhe rrjedhin nga pronësia mbi Kuotën dhe



2

Dhuruesi nuk ka asnjë të drejtë pronësie, dhe/ose të drejta vote dhe/ose çfarëdo të drejtash mbi administrimin e Shoqërisë që ka lidhje me apo rrjedh nga Kuota.

1.4 Pas transferimit të Kuotës nga Dhuruesit tek Përfituesi, kapitali i Shoqërisë do të zotërohet nga ortakët si vijon:

- **Sokol Xhabafti**, shtetas shqiptar, lindur me 03.01.1969, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 024623808 dhe nr. personal G901031261, mbajtës i një kuote që përfaqëson 32% (tridhjetë e dy përqind) të kapitalit të shoqërisë;
- **Neritan Bilibashi**, shtetas shqiptar, lindur me 25.11.1969, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 029216534 dhe nr. personal G91125107D, mbajtës i një kuote që përfaqëson 32% (tridhjetë e dy përqind) të kapitalit të shoqërisë;
- **Manfred Laaber**, shtetas Austriak, lindur me 10.09.1957, mbajtës i pasaportës me nr. P 7416269, mbajtës i një kuote që përfaqëson 32% (tridhjetë e dy përqind) të kapitalit të shoqërisë;
- **Sabian Shabani**, shtetas shqiptar, lindur me 05.02.1980, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 025469677 dhe nr. personal 100205150L, mbajtës i një kuote që përfaqëson 4% (katër përqind) të kapitalit të shoqërisë.

Neni 2

Pranimi

Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Përfituesi pranon Kuotën si më sipër dhe pranon se do të jetë përgjegjës për të gjithë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga pronësia mbi Kuotën në përputhje me kushtet e parashikuara në këtë Kontrate.

Neni 3

Tatimet dhe shpenzimet

- 3.1 Palët do të përballojnë kostot dhe shpenzimet e tyre përkatëse që kanë kryer në lidhje me negocimin, nënshkrimin dhe dorëzimin e kësaj Kontrate.
- 3.2 Përfituesi do të jetë përgjegjës për pagesën e çdo tatimi të aplikueshëm në lidhje me kuotën pas nënshkrimit të kësaj Kontrate.

Neni 4

Deklarime dhe Garanci

4.1 Dhuruesi deklaron dhe garanton Përfituesin si vijon:

- a) WELL Shpk është një shoqëri e themeluar dhe e regjistruar rregullisht në Regjistrin Tregtar, e cila ushtron aktivitetin tregtar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe statutin e Shoqërisë;



- b) Dhuruesit janë pronarë të ligjshëm të Kuotës përkatëse dhe kanë titull të plotë pronësie mbi të;
- c) Dhuruesit zotërojnë Kuotat të lira nga çdo peng, barre siguruese, pengese, pretendime të tretëve, kufizime, si dhe çdo masë tjetër sigurie apo ligjore. Nuk ekziston asnjë garanci, kontratë shitjeje kuotash, kontratë riblerjeje, kufizim i çfarëdo natyre, të çfarëdo lloji qofshin, në lidhje me Kuotat;
- d) Kapitali i Shoqërisë është shlyer rregullisht nga ortakët dhe nuk ka asnjë detyrim të pa përmbushur dhe/cse të shkelur nga ortakët në lidhje me shlyerjen e kapitalit të Shoqërisë;
- e) Dhuruesit zotërojnë Kuotën e tyre për llogari dhe në emrin e tyre, dhe nuk ekziston asnjë "ortak i fshehtë" ose detyrim tjetër përsa i përket ndarjes së fitimit;
- f) WELL Shpk nuk është në proces falimentimi ose likuidimi;
- g) Dhuruesit garantojnë se nuk kanë dijeni për ndonjë fakt apo çështje, fshehja e të cilave bën që secila prej këtyre deklaratave dhe garancive të jetë çorientuese apo që do të, apo mund të, ndikojë gjykimin e Përfituesit në lidhje me pranimin e Kuotave.

4.2 Përfituesi me anë të kësaj Kontrate deklaron dhe garanton Dhuruesit se:

- a) Ka të gjithë aftësitë juridike për të nënshkruar këtë Kontratë dhe se nuk ka asnjë pengese ligjore që do të cenonte aftësinë e tij për të nënshkruar apo përmbushur detyrimet që rrjedhin nga kjo Kontratë dhe kjo Kontratë përben një detyrim të vlefshëm të Përfituesit të zbatueshëm në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate;
- b) përmbush të gjitha kriteret për të ushtruar veprimtarinë e parashikuar në statutin e Shoqërisë;
- c) Nuk ka asnjë fakt, rrethancë apo informacion i cili mund të cenojë në çfarëdo mënyre aftësinë e tij për të ushtruar të drejtat dhe zbatuar detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i Kuotës.

Neni 5

Detyrime që lidhen me Kuotën

- 5.1 Përfituesi zotëhet se në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate e zotërimit të Kuotës do të kujdeset duke ndërmarrë të gjithë veprimet e nevojshme për të ruajtur interesin me të mirë të Shoqërisë dhe aktivitetit të saj tregtar si edhe do të zbatojë rregullisht Statutin dhe aktet e tjera në zbatim të tij të nxjerra nga Shoqëria.
- 5.2 Përfituesi do të kontribuojë me *know-how* në mënyrë që të përmirësohet me tej performancën dhe aktiviteti tregtar i Shoqërisë.

Neni 6

E drejta e parablerjes dhe kushte të tjera

- 6.1 Transferimi i Kuotës apo një pjese të saj nga Përfituesi drejt personave të tretë do të jetë subjekt i të drejtës së parablerjes në favor të Dhuruesve të cilët mund ta shfrytëzojnë këtë të drejtë sipas të

drejtave te përcaktuara ne dispozitat e Statutit te Shoqërisë dhe si me poshtë dhe proporcionalisht me Kuotet e Dhuruara.

- 6.2 Përfituesi nuk mund të transferojë kuotën në zotërim të tij për një periudhë 5 (pesë) vjeçare nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate. Ky kufizim nuk aplikohet në rast të transferimit ndaj ortakëve të tjerë.
- 6.3 Ne rast se Përfituesi kërkon te shesë dhe/ose transferoje një pjese ose te gjithë kuotën e tij, ai duhet ti ofroje fillimisht Dhuruesve kuotën qe propozohet te transferohet ("Kuotën e Ofruar"), proporcionalisht me kuotat e dhuruara subjekt i kërkesave dhe kushteve te mëposhtme dhe Statutit te Shoqërisë:
- a) Përfituesi duhet t'i dërgoje fillimisht Dhuruesve një njoftim me shkrim duke detajuar vlerën dhe përqiudjen ne kapitalin e regjistruar te Shoqërisë te Kuotës se Ofruar, dhe kushte te tjera materiale te transferues ("Oferta"), duke ftuar fillimisht Dhuruesit te blejnë Kuotën e Ofruar duke shfrytëzuar te drejtën e parablerjes. Kuota e ofruar ndaj Dhuruesve do ti jepet këtyre te fundit me te njëjtat kushte sipas se cilave Përfituesi synon ta transferoje drejt palëve te treta.
 - b) Dhuruesit kane te drejte qe, te blajnë/pranojnë ne dhurim Kuotën e Ofruar sipas kushteve te Ofertës duke dërguar një njoftim me shkrim tek Përfituesi.
- 6.4 Ne rast se Dhuruesit nuk zgjedhin te blejnë Kuotën e Ofruar dhe/ose kane refuzuar te blejnë këtë Kuote te Ofruar, sipas mënyrës se përcaktuar, Përfituesi do te ketë te drejte te transferoje Kuotën e Ofruar tek një pale e trete ne përputhje me kushtet e Ofertës fillestare.

Neni 7


Te ndryshme

7.1 Garanci te tjera.

Palët bien dakord qe te ndërmarrin ato veprime te tjera te cilat nuk parashikohen shprehimisht ne këtë Kontrate, siç mund te jete e nevojshme apo e dëshirueshme për realizimin e dhurimit te Kuotës sipas afateve dhe kushteve te përcaktuara ne këtë Kontrate. Me ndryshimin apo hyrjen ne fuqi te ndonjë ligji, rregulli apo rregulloreje qe do te ndikojë aftësinë e Dhuruesve për te dhuruar Kuotën apo te Përfituesit për te pranuar Kuotën sipas kushteve te kësaj Kontrate, Palët bien dakord qe te ndërmarrin këto veprime te tjera siç mund te jete e nevojshme apo e dëshirueshme dhe pranojnë ne mirëbesim te kryejnë këto procedura siç mund te jete e nevojshme apo e dëshirueshme për realizimin e dhurimit te Kuotës, ne përputhje me te gjitha ligjet, rregullat ose rregulloret qe bëhen te zbatueshme; me kusht, gjithsesi, qe asnjërës Pale te mos i kërkohet qe te ndërmarrë ndonjë prej këtyre veprimeve apo te respektojë këto procedura qe do t'i shkaktonin një barre te rende apo kosto dhe shpenzime shtese.

7.2 Forca Madhore.

Asnjëra Pale nuk do te jete përgjegjëse për mospërbushjen e detyrimeve te saj përkatëse sipas kësaj Kontrate ne rastin e Forcës Madhore. Për qëllimet e kësaj Kontrate, Forca Madhore do te nënkuptojë një ngjarje e cila nuk mund te parashikohet apo mënjanchet dhe qe shkon përtej



kontrollit të palëve duke e bërë të pamundur përmbushjen e çfarëdo detyrimi që rrjedh nga kjo Kontrate.

7.3 Njoftimet.

Te gjitha njoftimet, kërkesat, pyetjet dhe komunikimet e tjera të cilat kërkohen apo mund të jepen sipas kësaj Kontrate, do të jenë me shkrim dhe do të konsiderohen se janë dhënë rregullisht nëse dërgohen, në adresat e e-amilit të mëposhtme:

Për Dhuruesit:

Neritan Bilibashi - Rruga "Sefer Efendiu", Lagja nr. 2, Durrës, Albania

Sokol Xhabafti - Rruga e Scravës, Picar, Vorë, Tirana, Albania

Për Përfituesin:

Manfred Laaber - 8051 Graz, Anton Kleinoscheg-Strasse 64a, Austria

apo në atë adresë tjetër që pala do të ketë specifikuar nëpërmjet një njoftimi me shkrim dërguar palës tjetër.

7.4 Marrëveshja.

Kjo Kontrate përbën të gjithë Marrëveshjen dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet dhe rregullimet e mëparshme, verbale dhe të shkruara, ndërmjet Palëve në lidhje me objektin e kësaj Kontrate.

7.5 Transferimi.

Asnjëra palë nuk do të ketë të drejtë të japë apo transferojë të gjitha apo cilëndo prej të drejtave të saj, përfitimesve apo detyrimeve sipas kësaj Kontrate, pa miratimin paraprak me shkrim të palës tjetër.

7.6 Efektet detyruese.

Kjo Kontrate do të ketë fuqi detyruese për Palët.

7.7 Vijueshmëria.

Nëse ndonjë prej dispozitave të kësaj Kontrate konsiderohet e pavlefshme, e paligjshme apo e pazbatueshme, ajo do të modifikohet në minimumin e nevojshëm për ta kthyer të vlefshme, të ligjshme dhe të zbatueshme, ose, nëse një modifikim i tillë nuk është i mundur, kjo dispozite do të mënjanohet nga kjo Kontrate dhe dispozitat e tjera të kësaj Kontrate do të vazhdojnë të jenë plotësisht në fuqi dhe të vlefshme.

7.8 Ligji i zbatueshëm.

Kjo Kontrate dhe të gjitha transaksionet e parashikuara në të do të rregullohen, interpretohen dhe do të jenë të zbatueshme në përputhje me legjislacionin shqiptar.

7.9 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve.

Çdo konflikt, ndryshim, mosmarrëveshje apo pretendim i çfarëdollojti, sido që të ketë lindur, nga apo në lidhje me këtë Kontrate, përfshirë çdo pyetje që i përket Mospërmbushjes, ekzistencës,



vlefshmërisë apo zgjidhjes së kësaj Kontrate të cilat nuk zgjidhen në mënyrë miqësore mes Palëve, do t'i drejtohet dhe zgjidhet përfundimisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

7.10 Gjuha dhe kopjet.

Kjo Kontrate nënshkruhet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe angleze.

Për çdo paqartësi në lidhje me interpretimin e kësaj Kontrate, versioni Anglisht do të ketë përparësi.

7.11 Hyrja në fuqi

Kjo kontratë hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga të dy Palët.

DHURUESI

Sokol Xhabafti


(nënshkrimi)



DIHURUESI

Neritan Bilibashi


(nënshkrimi)



PERFITUESI

Manfred Laaber


(nënshkrimi)

KONTRATE DHURIMI KUOTASH

Ne Tirane, sot me date 8 Maj 2018, lidhet kjo kontrate dhurimi kuotash ("**Kontrata**"), me pale si me poshtë vijon:

- **Z. Sokol Xhabafti** shtetas shqiptar, lindur me 03.01.1969, mbajtës i letërnjoftimit me nr. 024623808 dhe nr. personal G901031261, madhor dhe me zotësi të plote për të vepruar, mbajtës i një kuote që përfaqëson 50% (pesëdhjete përqind) të kapitalit të shoqërisë WELL Shpk., një shoqëri e krijuar dhe që vepron në përputhje me legjislacionin shqiptar, me seli në adresën: Fshati Picar, Rruga e Serave, Objekt me nr. pasurie 245/26ND, ZK 3974, Vore, Tirane, Shqipëri, regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit me numër unik të identifikimit të subjektit (NUIS) L71416030S, (në vijim "**Dhuruesi**")

dhe

- **Z. Sabian Shabani**, shtetas shqiptar, lindur me 05.02.1980, mbajtës i letërnjoftimit nr. 025469677, me numër personal 100205150L, madhor dhe me zotësi të plote për të vepruar, (në vijim "**Përfituesi**")

Në vijim "**Dhuruesi**" dhe "**Përfituesi**", bashkërisht do të quhen "**Palët**" dhe secili prej tyre "**Pala**".

MEQENESE

- A. Dhuruesi, është bashkë ortak në shoqërinë **WELL Shpk.**, shoqëri e krijuar dhe që ekziston në përputhje me legjislacionin shqiptar, me seli në adresën: Fshati Picar, Rruga e Serave, Objekt me nr. pasurie 245/26ND, ZK 3974, Vore, Tirane, Shqipëri, e regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar mbajtur nga Qendra Kombëtare e Biznesit me numër identifikimi të subjektit (NUIS) L71416030S, me kapital në vlerën 100 000 Leke (njëqind mije) (në vijim "**Shoqëria**").
- B. Dhuruesi deklaron se është zotëruar i 1 (një) kuote e cila, me qëllim dhurimi, është e ndare në 2 (dy) kuota të cilat bashkërisht përfaqësojnë 50% të kapitalit të Shoqërisë, me vlerë si më poshtë vijon:
 - 1 kuote, përbërëse e 46% (dyzetë e gjashtë përqind) të kapitalit të Shoqërisë, me vlerë 46 000 Leke (dyzetë e gjashtë mije);
 - 1 kuote, përbërëse e 4% (katër përqind) të kapitalit të Shoqërisë, me vlerë 4.000 Leke (katër mije).
- C. Përfituesi është punëmarrës i shoqërisë në përputhje me kontratën e punës date 07.06.2017.
- D. Dhuruesi dëshiron t'i dhurojë Përfituesit 1 (një) kuote të zotëruar prej tij tek Shoqëria që korrespondon me 4% (katër përqind) të kapitalit, pa kundër shpërblim;

Sa më sipër, Dhuruesi dhe Përfituesi bien dakord të lidhin këtë Kontratë, me kushtet si vijon:



Neni 1

Objekti i Kontratës

- 1.1 Sipas kushteve dhe parashikimeve të kësaj Kontrate, Dhuruesi transferon nëpërmjet dhurimit dhe kalon në emër të Përfituesit, kuotën e zotëruar prej tij, e cila përfaqëson 4% (katër përqind) të kapitalit të Shoqërisë, dhe Përfituesi përfiton këtë kuotë nga Dhuruesi.
- 1.2 Përfituesi behet zotëruar me të drejta të plota i 1 (një) kuote, përfaqësuese e 4% (katër përqind) të kapitalit të Shoqërisë (në vijim "Kuota"), pas nënshkrimit të kësaj Kontrate.
- 1.3 Palët bien dakord që pas nënshkrimit të kësaj Kontrate, Përfituesi dhe do të ushtroje të gjitha të drejtat që lidhen me Kuotën dhe rrjedhin nga pronësia mbi Kuotën dhe Dhuruesi nuk ka asnjë të drejtë pronësie, dhe/ose të drejta vote dhe/ose çfarëdo të drejtash mbi administrimin e Shoqërisë që ka lidhje me apo rrjedh nga Kuota.

Neni 2

Tatimet dhe shpenzimet

- 2.1 Palët do të përballojnë kostot dhe shpenzimet e tyre përkatëse që kanë kryer në lidhje me negociimin, nënshkrimin dhe dorëzimin e kësaj Kontrate.
- 2.2 Përfituesi do të jetë përgjegjës për pagesën e çdo tatimi të aplikueshëm në lidhje me kuotën pas nënshkrimit të kësaj Kontrate.

Neni 3

Deklarime dhe Garanci

- 3.1 Dhuruesi deklaron dhe garanton Përfituesin si vijon:
 - a) WELL Shpk është një shoqëri e themeluar dhe e regjistruar rregullisht në Regjistrin Tregtar, e cila ushtron aktivitetin tregtar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi dhe statutin e Shoqërisë;
 - b) Dhuruesi është pronar i ligjshëm i Kuotës dhe ka titull të plote pronësie dhe zotëron të gjithë interesin e përfitimit kundrejt kësaj Kuote;
 - c) Dhuruesi zotëron Kuotën të lire nga çdo peng, barre siguruese, pengese, pretendime të tretëve, kufizime, si dhe çdo masë tjetër sigurie apo ligjore. Nuk ekziston asnjë garanci, e drejtë zgjedhjeje, kontrate shitjeje kuotash, kontrate riblerjeje, kufizim i çfarëdo natyre, të çfarëdo lloji qofshin, në lidhje me Kuotën;
 - d) Kapitali i Shoqërisë është shlyer rregullisht nga ortakët dhe nuk ka asnjë detyrim të pa përmbushur dhe/ose të shkelur nga ortaku në lidhje me shlyerjen e kapitalit të Shoqërisë;



2

- e) Dhuruesi zotëron Kuotën e tij për llogari dhe në emrin e vet, dhe nuk ekziston asnjë "ortak i fshehtë" ose detyrim tjetër për sa i përket ndarjes së fitimit;
- f) WELL Shpk nuk është në proces falimentimi ose likuidimi;
- g) Dhuruesi garanton se nuk ka asnjë dëgjim për ndonjë fakt apo çështje, fshehtë e të cilave bëjnë që secila prej këtyre deklaratave dhe garancive të jetë çorientuese apo që do të, apo mund të, ndikojë gjykimin e Përfituesit në lidhje me pranimin e Kuotës.

3.2 Përfituesi me anë të kësaj Kontrate deklaron dhe garanton Dhuruesin se:

- a) Ka të gjithë aftësitë juridike për të nënshkruar këtë Kontratë dhe se nuk ka asnjë pengesë ligjore që do të cenonte aftësinë e tij për të nënshkruar apo përmbushur detyrimet që rrjedhin nga kjo Kontratë dhe kjo Kontratë përbën një detyrim të vlefshëm të Përfituesit të zbatueshëm në përputhje me dispozitat e kësaj Kontrate;
- b) përmbush të gjitha kriteret për të ushtruar veprimtarinë e parashikuar në statutin e Shoqërisë;
- c) Nuk ka asnjë fakt, rrethane apo informacion i cili mund të çojë në çfarëdo mënyre aftësinë e tij për të ushtruar të drejtat dhe zbatuar detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i Kuotës.

Neni 4

Kushte që lidhen me Kuotën

- 4.1 Dhurimi i kuotës do të bëhet me kusht. Në rast se Përfituesi vendos të ndërpresë marrëdhënien e punës sipas kontratës datë 07.06.2017 me Shoqërinë, ai bie dakord se duhet t'i kthejë Kuotën Dhuruesit pa kundër shpërblim. Kuota do të kthehet e lirë nga çdo barre, peng, barre ligjore etj.
- 4.2 Përfituesi do të transferojë Kuotën pa kundër shpërblim drejt Dhuruesit brenda një afati prej 30 ditësh nga momenti i ndërprerjes së marrëdhënies së punës me Shoqërinë.
- 4.3 Me ndërprerje të marrëdhënies së punës do të kuptohet, dorëheqja nga ortakët ose përfundimi i marrëdhënies së punës në mënyrë të menjëhershme dhe/ose të justifikuar nga Punëdhënësi (Shoqëria).
- 4.4 Në rast se në momentin e përfundimit të marrëdhënies së punës së Përfituesit me Shoqërinë Kuota rezultojë e rënduar nga çdo peng, barre siguruese, pengesë, pretendime të të tjerëve, kufizime, garanci, e drejta zgjedhjeje, kontrate shitjeje kuotash, kontrate riblerjeje, kufizim i çfarëdo natyre, të çfarëdo lloji qofshin, në lidhje me Kuotën, si dhe çdo masë tjetër ligjore, zotohet të shlyejë detyrimet, dhe t'i transferojë Kuotën Dhuruesit të lirë nga çdo peng, barre siguruese, pengesë, pretendime të të tjerëve, kufizime, garanci, e drejta zgjedhjeje, kontrate shitjeje kuotash, kontrate riblerjeje, kufizim i çfarëdo natyre, të çfarëdo lloji qofshin, në lidhje me Kuotën, si dhe çdo masë tjetër ligjore.
- 4.5 Përfituesi zotohet se në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate e zotërimit të Kuotës do të kujdeset duke ndërmarrë të gjithë veprimet e nevojshme për të ruajtur interesin me të mirë të Shoqërisë së dhe do të zbatojë rregullisht Statutin dhe aktet e tjera në zbatim të tij të nxjerra nga Shoqëria.

Neni 5

E drejta e parablerjes dhe kushte te tjera

- 5.1 Transferimi i kuotës apo një pjese te saj nga Përfituesi drejt personave te trete do te jete subjekt i te drejtës se parablerjes ne favor te Dhuruesit i cili mund ta shfrytëzoje këtë te drejte sipas te drejtave te përcaktuara ne dispozitat e Statutit te Shoqërisë dhe si me poshtë.
- 5.2 Përfituesi nuk mund të transferojë kuotën në zotërim të tij për një periudhë 5 (pesë) vjeçare nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate. Ky kufizim nuk aplikohet në rast të transferimit ndaj ortakëve të tjerë.
- 5.3 Ne rast se Përfituesi kërkon te shesë dhe/ose transferoje një pjese ose te gjithë kuotën e tij, ai duhet t'i ofroje fillimisht Dhuruesit kuotën qe propozohet te transferohet ("Kuotën e Ofruar"), subjekt i kërkesave dhe kushteve te mëposhtme dhe Statutit te Shoqërisë:
- Përfituesi duhet t'i dërgojë fillimisht Dhuruesit një njoftim me shkrim duke detajuar vlerën dhe përqindjen ne kapitalin e regjistruar te Shoqërisë te Kuotës se Ofruar, dhe kushte te tjera materiale te transfertes ("Oferta"), duke ftuar fillimisht Dhuruesin te blejë Kuotën e Ofruar duke shfrytëzuar te drejtën e parablerjes. Kuota e ofruar ndaj Dhuruesit do t'i jepet këtij te fundit me te njëjtat kushte sipas se cilave Përfituesi synon ta transferoje drejt paleve te treta.
 - Dhuruesi ka te drejte qe, te blejë/pranoje ne dhurim Kuotën e Ofruar sipas kushteve te Ofertës duke dërguar një njoftim me shkrim tek Përfituesi.
- 5.4 Ne rast se Dhuruesi nuk zgjedh te blejë Kuotën e Ofruar dhe/ose ka refuzuar te blejë këtë Kuote te Ofruar, sipas mënyrës se përcaktuar, Përfituesi do te këtë te drejte te transferoje Kuotën e Ofruar tek një pale e trete ne përputhje me kushtet e Ofertës fillestare.

Neni 6

Pranimi

Per te shmangur çdo paqartësi dhe/ose dyshim, Përfituesi pranon Kuotën si me sipër ne përputhje me kushtet dhe kufizimet e parashikuara ne këtë Kontrate dhe ne Statutin e Shoqërisë. Përfituesi është ne dijeni te kushtit, dhe zotohet se ne momentin e ndërprerjes se marrëdhënies se punës me Shoqërinë sipas parashikimeve te kësaj Kontrate do te transferoje Kuotën pa kundër shpërblim drejt Dhuruesit te lire nga çdo peng, barre sigaruese, pengese, pretendime te te treteve, kufizime, garanci, e drejte zgjedhjeje, kontrate shitjeje kuotash, kontrate riblerjeje, kufizim i çfarëdo natyre, te çfarëdo lloji qofshin, ne lidhje me Kuotën, si dhe çdo mase tjetër ligjore.

Neni 7

Te ndryshme

- 7.1 Garanci te tjera.



Palët bien dakord që të ndërmarrin ato veprime të tjera të cilat nuk parashikohen shprehimisht në këtë Kontratë, siç mund të jete e nevojshme apo e dëshirueshme për realizimin e dhurimit të Kuotës sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në këtë Kontratë. Me ndryshimin apo hyrjen në fuqi të ndonjë ligji, rregulli apo rregulloreje që do të ndikojë aftësinë e Dhuruesit për të dhuruar Kuotën apo të Përfituesit për të pranuar Kuotën sipas kushteve të kësaj Kontrate, Palët bien dakord që të ndërmarrin këto veprime të tjera siç mund të jete e nevojshme apo e dëshirueshme dhe pranojnë në mirëbesim të kryejnë këto procedura siç mund të jete e nevojshme apo e dëshirueshme për realizimin e dhurimit të Kuotës, në përputhje me të gjitha ligjet, rregullat ose rregulloret që bëhen të zbatueshme; me kusht, gjithsesi, që asnjërës Palë të mos i kërkohet që të ndërmarrë ndonjë prej këtyre veprimeve apo të respektojë këto procedura që do t'i shkaktonin një barre të rëndë apo kosto dhe shpenzime shtese.

7.2 Forca Madhore.

Asnjëra Palë nuk do të jete përgjegjëse për mos përmbushjen e detyrimeve të saj përkatëse sipas kësaj Kontrate në rastin e Forcës Madhore. Për qëllimet e kësaj Kontrate, Forca Madhore do të nënkuptojë një ngjarje e cila nuk mund të parashikohet apo mënjanohet dhe që shkon përtej kontrollit të palëve duke e bërë të pamundur përmbushjen e çfarëdo detyrimi që rrjedh nga kjo Kontratë.

7.3 Njoftimet.

Të gjitha njoftimet, kërkesat, pyetjet dhe komunikimet e tjera të cilat kërkohen apo mund të jepen sipas kësaj Kontrate, do të jene me shkrim dhe do të konsiderohen se janë dhënë rregullisht nëse dërgohen, në adresat e e-mailit të mëposhtme:

Per Dhuruesin:

Sokol Xhabafti - Rruga e Serave, Picar, Vorc, Tirane

Per Përfituesin:

Sabian Shabani - Rruga Jordan Misja, Kompleksi Gener 2, Shkalla F, Ap.9, Tirane

apo në atë adresë tjetër që pala do të ketë specifikuar nëpërmjet një njoftimi me shkrim dërguar palës tjetër.

7.4 Marrëveshja.

Kjo Kontratë përbën të gjithë Marrëveshjen dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet dhe rregullimet e mëparshme, verbale dhe të shkruara, ndërmjet Palëve në lidhje me objektin e kësaj Kontrate.

7.5 Transferimi.

Asnjëra palë nuk do të ketë të drejtë të japë apo transferojë të gjitha apo cilëndo prej të drejtave të saj, përfitimeve apo detyrimeve sipas kësaj Kontrate, pa miratimin paraprak me shkrim të palës tjetër.

7.6 Efektet detyruese.

Kjo Kontratë do të ketë fuqi detyruese për Palët.



7.7 Veçueshmeria.

Nëse ndonjë prej dispozitave të kësaj Kontrate konsiderohet e pavlefshme, e paligjshme apo e pazbatueshme, ajo do të modifikohet në minimumin e nevojshëm për ta kthyer të vlefshme, të ligjshme dhe të zbatueshme, ose, nëse një modifikim i tillë nuk është i mundur, kjo dispozite do të mënjanohet nga kjo Kontrate dhe dispozitat e tjera të kësaj Kontrate do të vazhdojnë të jenë plotësisht në fuqi dhe të vlefshme.

7.8 Ligji i zbatueshëm

Kjo Kontrate dhe të gjitha transaksionet e parashikuara në të do të rregullohen, interpretohen dhe do të jenë të zbatueshme në përputhje me legjislacionin shqiptar.

7.9 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve.

Çdo konflikt, ndryshim, mosmarrëveshje apo pretendim i çfarëdolloj, sido që të ketë lindur, nga apo në lidhje me këtë Kontrate, përfshirë çdo pyetje që i përket mos përmbushjes, ekzistencës, vlefshmërisë apo zgjidhjes së kësaj Kontrate të cilat nuk zgjidhen në mënyrë miqësore mes Palëve, do t'i drejtohet dhe zgjidhet përfundimisht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

7.10 Gjuha dhe kopjet.


Kjo Kontrate nënshkruhet në 2 (dy) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

7.11 Hyrja në fuqi

Kjo kontrate hyn në fuqi me nënshkrimin e saj nga të dy Palët.

DHURUESI

Z. Sokol Xhabafti




(nënshkrimi)



PERFITUESI

Z. Sabian Shabani



(nënshkrimi)

